

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Energjia fotovoltaike, shtyllë e zhvillimit tonë ekonomik?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/energjia-fotovoltaike-shtylle-e-zhvillimit-tone-ekonomik-i587317
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 16:43:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 16:50:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e44cb450af9e73e61f572aba6ad14ace34912fcffba33c6fa6f25dcb9eaa7
TEKSTI	f5a39df2c837bfb2a42194c6809813c0cbf3aba63eee36dc31c896cdef2215d
PAMJA	caa5a1dda5c43d0b6b8bd7241a9494243a34b3982eee5ccb865b4e850864a146

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a4d062eb714bbc93320cf3881d9747655e51964779f4352ea52d2d29626b663b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a4d062eb714bbc93320cf3881d9747655e51964779f4352ea52d2d29626b663b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Retuzoi Shqiperine dhe mori ftesen e pare nga Gjermania ,Brajan Gruda demtohet pak dite para grumbullimit me "Panzerat"Ukraina sulmon per here te pare Rusine me fundit](#)

Energjia fotovoltaike, shtyllë e zhvillimit tonë ekonomik?



20 Shtator 2026, 18:50Ekonomia TEMA



Nga Fatos Çoçoli

Rritja e prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike po e ndryshon gradualisht strukturën e sistemit tonë elektroenergjetik.

Sipas të dhënave të ERE, 30 përqind e energjisë së konsumuar tek ne gjatë qershorit 2026 u prodhua nga energjia diellore. Nga niveli 11 përqind i prodhimit total të energjisë për vitin 2025, treguesi i qershori i qershori 2026 përbën një tregues të rëndësishëm të zgjerimit të burimeve të energjisë fotovoltaike dhe të diversifikimit të prodhimit të Shqipërisë.

Po aq domethënës është edhe fakti se, deri në fund të gushtit 2026, prodhimi nga fotovoltaiKET arriti në 868 gigavat-orë(GWh).

Për një sistem që historikisht është mbështetur në mënyrë pothuajse totale tek hidrocentralet, kjo rritje krijon një burim të dytë të besueshëm dhe të rëndësishëm të energjisë së rinovueshme. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë tonë energjetike, duke ulur importet, përmirësuar bilancin tonë tregtar dhe shtuar qëndrueshmërinë e ekonomisë. Sipas INSTAT, gjatë periudhës janar-gusht 2026, çmimet e energjisë elektrike u ulën mesatarisht me 2.2%.

Më në fund, vendi ynë po humb gradualisht varësinë e lartë nga hidroenergjia

Një nga dobësitë strukturore të sistemit shqiptar të prodhimit të energjisë elektrike ka qenë varësia e konsiderueshme nga prodhimi hidroenergjetik. Kur reshjet janë të pakta dhe nivelet e rezervuarëve bien, prodhimi vendas zvogëlohet dhe nevoja për importe rritet dukshëm.

Energjia diellore krijon një mekanizëm natyror diversifikimi. Periudhat me prodhim të lartë fotovoltaiK zakonisht përkojnë me muajt me më shumë diell, pikërisht kur kërkesa dhe konsumi për energji shtohet fort, nga temperaturat e larta dhe për shkak të përdorimit të kondicionerëve. Në këtë mënyrë, fotovoltaiKET po kontribuojnë në mbulimin e një pjese të mirë të kërkesës në periudhat e pikut. Për qershorin 2026 ishte një e treta e kërkesës. Një ritëm të tillë energjia diellore ka ruajtur edhe në dy muajt e tjerë të verës 2026.

868 GWh prodhim fotovoltaiK deri në gusht 2026 tregon se energjia diellore nuk është më vetëm një burim plotësues apo një sektor në fazë eksperimentale. Ajo po bëhet një komponent real i bilancit energjetik kombëtar.

Më shumë prodhim vendas, të thotë më pak ekspozim ndaj importeve

Kur prodhimi vendas nuk mjafton për të mbuluar konsumin, ne duhet të blejmë energji në tregjet rajonale, në pikun e çmimit të kesaj energjie. Çdo gigavat-orë (GWh) e prodhuar nga një burim vendas i rinovueshëm e redukton nevojën për blerje nga jashtë.

Kjo ka rëndësi ekonomike për ne, për dy arsye. Së pari, pakëson ekspozimin ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare. Së dyti, ndihmon në përmirësimin e bilancit tonë energjetik dhe, potencialisht, edhe të atij tregtar.

Prandaj, investimi në kapacitete fotovoltaike duhet parë edhe si politikë e sigurisë ekonomike.

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm diellor, ndërsa zgjerimi i teknologjisë fotovoltaike ka bërë që kostoja e instalimit dhe prodhimit të energjisë diellore të jetë shumë më konkurruese se në të kaluarën. Kjo krijon mundësi për ta kthyer diellin, nga një burim natyror i pashfrytëzuar plotësisht, në një aset ekonomik kombëtar.

Me kapacitetet fotovoltaike që vazhdojnë të rriten çdo javë e muaj që kalon, Shqipëria po krijon një portofol më të balancuar energjitik. Dhe sa më i diversifikuar të jetë ky portofol, aq më e vogël është varësia e sistemit tonë nga një burim i vetëm.

Fotovoltaiket po ndryshojnë edhe ekonominë e prodhimit

Një tjetër efekt i rëndësishëm është krijimi i një sektori të ri ekonomik rreth energjisë diellore. Zgjerimi i impianteve fotovoltaike kërkon investime private, kompani ndërtimi dhe instalimi, inxhinierë dhe teknikë, mirëmbajtje dhe monitorim, pajisje elektrike dhe elektronike, si dhe sisteme të menaxhimit dhe ruajtjes së energjisë.

Kjo do të thotë se tranzicioni energjetik nuk prodhon vetëm kilovat-orë. Ai krijon aktivitet ekonomik, vende pune dhe tregje të reja shërbimesh.

Për bizneset shqiptare, kostoja dhe siguria e furnizimit me energji janë pjesë e drejtpërdrejtë e konkurrueshmërisë së tyre. Një kompani që investon në prodhim fotovoltaike për konsum vetjak mund të ulë ekspozimin ndaj çmimeve të energjisë dhe të krijojë më shumë parashikueshmëri për kostot e saj operative.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për industrinë përpunuese, për bujqësinë dhe serrat, për hotelerinë, qendrat tregtare, magazinat dhe logjistikën. Pra, zgjerimi i fotovoltaikeve mund të ndikojë edhe në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare.

Qershori 2026 tregoi potencialin e kombinimit diell-hidro

Një avantazh specifik i Shqipërisë është mundësia për të kombinuar dy burime të rinovueshme me karakteristika të ndryshme. Energjia diellore prodhon më shumë gjatë ditës dhe sidomos gjatë muajve me rrezatim të lartë. Hidrocentralet, ndërkohë, kanë mundësi më të madhe për të menaxhuar prodhimin në funksion të kushteve të sistemit dhe disponueshmërisë së ujit.

Kjo krijon mundësi për një sistem hibrid hidro-diellor, ku burimet plotësojnë njëri-tjetrin. Në këtë këndvështrim, shifra prej 30% të konsumit të qershorit të mbuluar nga fotovoltaiket ka rëndësi përtej vetë volumit të energjisë. Ajo tregon se profili i prodhimit shqiptar po ndryshon.

Rritja e prodhimit fotovoltaike po krijon një efekt pozitiv në të gjithë zinxhirin e investimeve energjetike. Kur një teknologji arrin të zërrë një pjesë të konsiderueshme të konsumit kombëtar, rritet interesi për impiante të reja, parqe diellore më të mëdha, projekte hibride, bateri dhe sisteme të ruajtjes, rrjete transmetimi dhe shpërndarjeje, si dhe teknologji smart-grid.

Në këtë kuptim, shifra e 868 GWh të prodhuar nga fotovoltaiket për periudhën janar-gusht 2026 nuk përbën vetëm një statistikë energjetike, por është edhe një sinjal për transformimin e tregut shqiptar të energjisë.

Investimet në kapacitetet e prodhimit duhet të shoqërohen me investime në infrastrukturën që e transporton dhe e menaxhon këtë energji. Sfida e fazës së ardhshme është që Shqipëria të mos mjaftohet me shtimin e paneleve diellore. Duhet të ndërtojmë paralelisht rrjetet, kapacitetet e ruajtjes, sistemet e menaxhimit dhe interkoneksionet, të cilat do ta bëjnë të mundur shfrytëzimin maksimal të kesaj energjie.

Kështu energjia diellore po shndërrohet, nga një burim alternativ, në një prej shtyllave kryesore të sigurisë energjetike dhe të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[SEPA nxit remitancat, BSH: Ulja e kostove ka shtuar dërgesat e emigrantëve](#)

15:10 Ekonomia / 1 koment

Hyn në fuqi manuali i ri doganor për automjetet, fatura mbetet primare, kilometrazhi përfshihet si kriter vlerësimi, ja çfarë ndryshon në zhdoganimin e makinave

22:05 Ekonomia / 2 komente

A po i afrohet paga vlerës reale të punës, tregu që po rishkruan peshën e diplomës, aftësisë dhe përvojës

20:05 Ekonomia / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.